



INTERNET: [www.bundesgesundheitsministerium.de](http://www.bundesgesundheitsministerium.de)  
[www.zusammengegencorona.de](http://www.zusammengegencorona.de)

## **Rregulla në lidhje me koronavirusin SARS-CoV-2/COVID-19 për personat që hyjnë në Gjermani**

Shumë të nderuar udhëtarë,

përzemërsisht mirëserdhët në Gjermani! Ju lutem respektoni këto udhëzime të rëndësishme:

- Kur hyni në rrugë tokësore, detare ose ajrore nga shtete të tjera në Republikën Federale të Gjermanisë dhe kur keni qëndruar 10 ditë para hyrjes në një **zonë rreziku**, me përjashtim të rasteve të përmendura më poshtë, jeni të detyruar që **menjëherë** pas hyrjes të shkoni në rrugë direkte **në shtëpinë tuaj ose në një strehim tjetër të përshtatshëm** si dhe të qëndroni në vazhdimësi pa ndërprerje atje për një periudhë kohore prej 10 ditësh që pas hyrjes suaj në Gjermani (karantinë).
- **Zonë rreziku** është një shtet ose zonë jashtë Republikës Federale të Gjermanisë për të cilin apo për të cilën, në kohën e hyrjes në Republikën Federale të Gjermanisë, ekziston një rrezik i shtuar i infektimit me koronavirusin SARS-CoV-2. Instituti Robert Koch përditëson vazhdimisht një listë të zonave të rrezikut nën linkun: <https://www.rki.de/covid-19-risikogebiete>
- Detyrimi i përshkruar aplikohet në bazë të dispozitave të legjislatcionit të landeve federale sipas § 32 fjalia 1 në lidhje me § 30 paragrafi 1 fjalia 2 të Ligjit të Mbrojtjes nga Infektimi. Shkeljet mund të ndiqen si shkelje ligjore me një gjobë deri në 25.000 euro.
- Ju keni më tej detyrimin t'i njoftoni **adresën e qëndrimit** në territorin federal autoritetit shëndetësor përgjegjës për ju. Për këtë qëllim, ju duhet të përdorni formularin digjital të regjistrimit të hyrjes në adresën <https://www.einreiseanmeldung.de>, ta mbani me vete dëshminë për këtë kur të hyni në Gjermani dhe t'ia paraqisni transportuesit, po t'ua kërkojë. Në rastin e hyrjes në rrugë ajrore nga jashtë Zonës së Shengenit<sup>1</sup> dëshmia e hyrjes do të kontrollohet nga autoriteti përgjegjës i ngarkuar me kontrollin policor të qarkullimit ndërkufitar, i cili zakonisht është Policia Federale. Zyra përkatëse e Shëndetit Publik monitoron respektimin e detyrimit të qëndrimit në karantinë; atë mund ta gjeni në internet në adresën: <https://tools.rki.de/plztool/>
- Në rastet kur për ju nuk është e mundur që të bëni një regjistrim digjital të hyrjes, për shkak të mungesës së pajisjeve teknike ose të një difekti teknik, jeni të detyruar të plotësoni një deklaratë zëvendësuese dhe t'ia dorëzoni transportuesit ose autoritetit të lartpërmendur gjatë kontrollit kufitar.
- Për grupe të caktuara njerëzish ka **përjashtime nga detyrimi për karantinë** sipas rregulloreve të landeve federale. Këtu bëjnë pjesë persona që hyjnë në Republikën Federale të Gjermanisë vetëm për **tranzit**. Karantina 10-ditore mund të ndërpritet në përputhje me rregulloret në fuqi të landeve federale më e herta pas ditës së pestë pas hyrjes në Gjermani, kur rezultati i testit për infektimin me koronavirusin SARS-CoV-2 del negativ.
- Edhe kur rezultati i testit është negativ, ju keni detyrimin të **kontaktit** menjëherë **Zyrën e Shëndetit Publik** kompetente për ju, kur 10 ditë pasi keni hyrë në Gjermani keni **simptoma tipike** (vështirësi në frymëmarrje, kollë të re, ethe ose humbje të nuhatjes ose shijes) të infektimit me koronavirusin SARS-CoV-2

Ministria juaj Federale për Shëndetin



Zona rreziku



Rregulla higjienike

<sup>1</sup> Belgjika, Danimarka, Gjermania, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Austria, Polonia, Portugalia, Suedia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Republika Çeke, Hungaria si dhe Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra.